

## MBLEDHJA E RADHËS E BORDIT TEKNIK (BT)

### *“Miratohet programi i punës për 6-mujorin e parë të vitit 2012”*

*19 Janar 2012*

Më datë 19 Janar 2012, në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, u mbajt takimi i BT për 6 mujorin e parë të vitit 2012.



Kryetari i Bordit Teknik Z. Bashkim Muça, evidentoi praninë e kuorumit dhe paraqiti rendin e ditës për të pranishmit.

Pas shqyrtimit të listave me standardet e propozuara për miratim në 6-mujorin e parë të vitit 2012 anëtarët e BT i miratuan ato duke arritur konsensus të plotë. Nuk pati asnjë koment apo kërkesë për shtesa në lista.

Me tej në përputhje me rendin e ditës u propozuan disa dyshime në Komitetet Teknike sipas listës së njohur paraprakisht nga pjesëmarrësit në mbledhje të cilat u miratuan po me konsensus nga anëtarët e Bordit Teknik. Nuk pati asnjë koment apo kërkesë për ndryshime në lista.



Grupi i Punës për përshtatjen e shtojcave kombëtare të standardeve bazë të naftës, benzinës dhe gazit, i miratuar me vendim elektronik të Bordit Teknik të DPS, datë 10 Tetor 2011, është ngritur dhe ka vazhduar punë rregullisht.

Bordi Teknik miratoi:

- *Listën me standardet e propozuara për miratim në 6-mujorin e parë të vitit;*
- *Disa ndryshime në Komitetet Teknike.*

Mbledhja e ardhshme për miratimin e programit të punës të DPS për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2012 do të mbahet brenda 10 ditëshit të parë të muajit Korrik të 2012.

*Tiranë, më 19.01.2012*